



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Kompania Regjionale e Mbeturinave/ Regional waste Company/ Regionalna Kompanija za Uklanjanja Otpada



KRM "PASTËRTIA" SH.A. FERIZAJ

Rr. "Enver Topalli" Nr. 47 Tel. 0290/325-025

Mbështetur në nenin 8, 10 paragrafi 2.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe në bazë të Vendimit me nr.711, Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, Ri-shpallë:

K O N K U R S

Për vendin e punës:

Nr. i referencës së pozitës së punës:

- 1 Kontroll Tereni

Nr. 1-736/23

Përgjegjësi mbikqyrëse: Jo

Raportimi: Udhëheqësve të lëmive përkatës

Orari i plotë i punës: Po

Kohëzgjatja e emërimit, Në kohë të caktuar/ Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit

Koeficientet: Në harmoni me politikat zhvillimore të Kompanisë

Vendi i punës: Ferizaj.

Dokumentet e nevojshme:

- Aplikacionin për punësim;
- CV-ja;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmia për kualifikim;

- Dëshminë që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Kandidati i cili arrin pikët e mjaftueshme për pranim, është i obliguar të sjellin Çertifikatë shëndetësore.

Përshkrimi i vendit të punës dhe përvoja e punës:

Kontroll Tereni:

Kontrollon tërë zonën e shërbimit. Në rast të moskryerjes efektive të punëve nga ana e punëtorëve në teren, konstaton me përgjegjësit e drejtëpërdrejtë të Operativës në mënyrë që të evitohen dobësitë eventuale. Merr vërejtjet eventuale nga klientët dhe të njëjtet i paraqet te kompetentët e kompanisë. Kryen punët dhe detyrat e punës sipas urdhëresës së udhëheqësit të drejtëpërdrejtë dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Dëshmia për kualifikim: Diplomën e Shkollës së Mesme.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aplikacioni mund të merret në zyret e KRM "Pastërtia" Sh.A. Ferizaj, Rr. "Enver Topalli" Nr.47 Ferizaj, ku edhe bëhet dorëzimi i Aplikacionit së bashku me dokumantacionin e kërkuar, apo mund të shkarkohet edhe në web-faqen e Kompanisë: www.pastertia.com.

Afati i konkursit për aplikim është i hapur 17 ditë kalendarik nga dita e publikimit në web-faqen e Kompanisë si dhe në shtypin ditor, duke filluar nga data **14.02.2023 deri 28.02.2023 ora 15:00.**

Për informata shtesë mund të kontaktoni numrin e tel. 0290/325-025.